

LIGJ
Nr.7651, datë 21.12.1992
Për festat zyrtare e ditët përkujtimore¹

(ndryshuar me ligjet: nr.7770, datë 7.12.1993; nr. 7780, datë 22.12.1993, nr.8065, datë 8.2.1996; ndryshuar titulli me ligjin nr.8214, datë 7.5.1997; nr.8253, datë 30.10.1997; nr.9137, datë 25.9.2003; nr.9222, datë 15.4.2004; nr.10 226, datë 4.2.2010; nr.1/2018, datë 25.1.2018)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

(ndryshuar pika "c" me ligjin nr.7770, datë 7.12.1993; ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 7780, datë 22.12.1993; shtuar shkronja "f" me ligjin nr.8065, datë 8.2.1996; ndryshuar shkronja "c" dhe shtuar shkronja c/1 me ligjin nr.8253, datë 30.10.1997; shtuar shkronja b/1 me ligjin nr.9137, datë 25.9.2003; shtuar shkronja "g" me ligjin 9222, datë 15.4.2004; shtuar shkronja "gj" dhe shfuqizuar paragrafi i dytë me ligjin nr.10 226, datë 4.2.2010; ndryshuar shkronja b/1 me ligjin nr.1/2018, datë 25.1.2018)

Janë ditë pushimi ditët e këtyre festave zyrtare:

- a) 1 dhe 2 janari - Viti i Ri.
- b) 1 Maji, dita ndërkombëtare e punonjësve.
- b/1) 5 shtatori- Dita e Shenjtërimit të Shenjt Terezës.
- c) 28 Nëntori dita e Flamurit dhe e Pavarësisë është ditë e festës kombëtare.
- c/1) 29 Nëntori dita e Çlirimit të Shqipërisë nga pushtuesi nazifashistë.
- ç) Bajrami i Madh, dita e parë.
- d) Bajrami i Vogël, dita e parë.
- dh) Pashkët Ortodokse, dita e parë.
- e) Pashkët Katolike, dita e parë.
- ë) Krishtlindjet, dita e parë.
- f) 22 marsi, Dita e Nevruzit.
- g) 14 Marsi – Dita e Verës.
- gj) 8 dhjetori – Dita Kombëtare e Rinisë.

Neni 2

Pranë Këshillit të Ministrave të ngrihet një komision për t'i propozuar parlamentit katalogun e plotë të festave zyrtare dhe jo zyrtare.

¹ Ligji nr.7651, datë 21.12.1992 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.10/1992.
Ligji nr.7770, datë 7.12.1993 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.14/1993.
Ligji nr.8065, datë 8.2.1996 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.2/1996.
Ligji nr.8214, datë 7.5.1997 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.6/1997.
Ligji nr.8253, datë 30.10.1997 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.16/1997.
Ligji nr.9137, datë 25.9.2003 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.81/2003.
Ligji nr.9222, datë 15.4.2004 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.32/2004.
Ligji nr.10 226, datë 4.2.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.13/2010.
Ligji nr.1/2018, datë 25.1.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.18/2018.

Neni 3

Dekreti nr.1600, datë 8.1.1953 "Për festat zyrtare", si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shhfuzqizohen.

(PARASHIKUAR ME LIGJIN NR. 8214, DATË 7.5.1997)

Të quhet ditë përkujtimore "Dita e Nënës", e cila do të jetë e diela e dytë e muajit maj.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.401, datë 23.12.1992, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.